



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2019:072278

Datë: 13.02.2020

Numri i dokumentit: 00832368

**P.nr.1/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK**, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit L.XH nga fshati..... Komuna e Kaçanikut, i akuzuar për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.2516-6/2018 të datës 28.12.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më datë 21.01.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit Besnik Nuredini dhe të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli ndërsa më datë 13.02.2020 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:** L.XH nga fshati ..... nga Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë.....nga i ati G..... dhe e ëma G.....e gjinisë Sh....., beqar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës, i pa gjykuar më parë, mbrohet në liri.

### **ËSHTË FAJTOR**

Më datë 09.11.2018, rreth orës 10:15, në vendin e quajtur “.....” në Rajonin Ekonomiko Pyjor ..... Komuna e Kaçanikut, me qëllim të vjedhje, në pyllin e pronësisë shoqërore, me sharrë motorike ka prerë 14 trungje druri të llojit të ahut, pa diametër të caktuar, me gjatësi prej 18 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 2.10 m<sup>3</sup>, të cilat i ka transportuar me traktor ferguson me kerr, duke i shkaktuar dëm Drejtorisë për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltarisë në Kaçanik, në vlerë prej 381.16 €.

Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 2, 41, 46, 50, 51, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 453 të KPPK-së i shqipton:

## **DËNIM ME KUSHT**

I. Dënim me gjobë në shumën prej 300€ (tre qind) eurove, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i pandehuri në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjykata do t'i revokon dënimin me kusht

II. Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar t'ia paguaj dëmin në shumë prej 381.16€.

III. Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

### **1. Pjesa hyrëse**

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën kundër të pandehurit L.XH nga fshati .....Komuna e Kaçanikut, i akuzuar për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.2516-6/2018 të datës 28.12.2018 dhe ka propozuar që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 21.01.2020.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit ngase i njëjti është bërë konform nenit 248 të KPP-së, dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe t'i shqipton dënim sipas ligjit.

### **2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë**

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- Pranimi është bërë vullnetarisht;
- Pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 par 1 të KPRK-së, në mënyrë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### 3. Rrethane lehtësuese dhe rënduese

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70, 71, 72 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se e ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, drunjët i kishte marrë për nevoja personale, si dhe faktin se kishte rënë ndesh për herë të parë me ligjin. Gjukata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përpos veprimeve që plotësojnë figurën e veprës penale.

Gjukata të pandehurit i shqiptoi dënim të kushtëzuar duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë dhe si dhe faktin se drunjët i ka prerë për nevoja personale dhe ka shprehur pendesë për veprën e kryer, gjykata konsideron se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorëve të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

### 4. Vendimi për kërkesat pasurore juridike

Vendimi për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar, është marrë në bazë të nenit 458 par 2 të KPPK-së dhe duke u bazuar në pranimin e fajësisë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe vlerësimit të dëmit të vlerësuar nga pala e dëmtuar.

### 5. Vendimi për shpenzimet e procedurës

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, u detyrua i pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, në t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 20.00 € dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

**Dega në Kaçanik**

**P.nr.1/19 datë 13.02.2020**

Procesmbajtësja  
Suzane Rudi

Gjyqtari  
Burim Çaka

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.